






Problema me 3 pikë

1. Cila nga retë e mëposhtme përmban katër numra çift?



2. Dhjetë çerekë ore janë të njëjta me:

(A) 40 orë


(B) 5 orë e gjysmë

(C) 4 orë

(D) 3 orë

(E) 2 orë e gjysmë

3. Një kub $3 \times 3 \times 3$ është ndërtuar me kube $1 \times 1 \times 1$. Disa kube hiqen nga pjesa e përparme drejt së pasmes, nga e majta në të djathtë dhe nga lartë - poshtë, siç paraqitet në figurë. Sa kube $1 \times 1 \times 1$ kanë mbetur?



(A) 15







(B) 18

(C) 20



(D) 21

(E) 22

4. Tre unaza janë të lidhura, si në figurë. Cila nga figurat e mëposhtme paraqet përsëri tre unazat e lidhura në të njëjtën mënyrë?



5. Cila nga figurat e mëposhtme nuk mund të vizatohet pa shkëputur majën e lapsit nga fleta dhe pa përsëritur vizatimin e një pjese të figurës dy herë?



6. Një ditë vere u takuan pesë shokë. Secili prej tyre i dha çdo shoku një karamele. Më pas, secili hëngri të gjitha karamelat që mori nga shokët. Si rezultat, numri i përgjithshëm i karamelave u



përgjysmua. Sa ishte numri i karamелеve që kishin së bashku në fillim?

- (A) 20 (B) 24 (C) 30 (D) 40 (E) 60


7. Në një garë, Luani mbaroi përpara Fredit, Viktori mbaroi pas Petritit, Fredi mbaroi përpara Petritit dhe Edi mbaroi përpara Viktorit. Cili nga pesë lojtarët e mbaroi garën i fundit?

- (A) Viktori (B) Fredi (C) Luani (D) Petriti (E) Edi

8. Xhulieta numëroi faqet që kishte lexuar nga një libër. Numrat e përdorur në faqet e lexuara përmbanin saktësisht pesë herë shifrën 0 dhe saktësisht gjashtë herë shifrën 8. Cili nga numrat e mëposhtëm mund të jetë numri i faqes së fundit që kishte lexuar Xhulieta?

- (A) 48 (B) 58 (C) 60 (D) 68 (E) 88

9. Një katror i madh është ndarë në katrorë më të vegjël. Cila pjesë e katrorit të madh është



ngjyrosur me gri?


- (A) $\frac{2}{3}$ (B) $\frac{2}{5}$ (C) $\frac{4}{7}$ (D) $\frac{4}{9}$ (E) $\frac{5}{12}$

10. Antoni ndau disa mollë në gjashtë grupe me numët të njëjtë mollësh. Bardhyli ndau të njëjtin numër mollësh në pesë grupe me numët të njëjtë mollësh. Bardhyli vuri re që secili prej grupeve të tij përmbante dy mollë më tepër se secili prej grupeve të Antonit. Sa mollë kishte Antoni?

- (A) 60 (B) 65 (C) 70 (D) 75 (E) 80


Problema me 4 pikë

11. Në secilën nga tre copave prej letre është shkruar nga një numër katër-shifror. Në figurë tregohet vendosja e këtyre copave ku janë mbuluar tre prej shifrave. Shuma e tre numrave katër-shifrorë është 10126. Cilat janë shifrat e mbuluara?










- (A) 5, 6 dhe 7 (B) 4, 5 dhe 7 (C) 4, 6 dhe 7 (D) 4, 5 dhe 6 (E) 3, 5 dhe 6

12. Në $\triangle PQS$ kemi $PQ = PR = QS$ dhe këndi $\widehat{QPR} = 20^\circ$ (fig.). Sa është masa e këndit \widehat{RQS} ?



- (A) 50° (B) 60° (C) 65° (D) 70° (E) 75°

13. Cila nga pllakat e mëposhtme 4×4 nuk mund të formohet duke bashkuar dy pjesët e dhëna?




14. Altini, Bardha, Djella, Fjolla dhe Erindi u takuan në një mbrëmje dhe i shtrënguan duart vetëm një herë me secilin që njihnin. Altini i shtrëngoi duart një herë, Bardha i shtrëngoi duart dy herë, Djella i shtrëngoi duart tre herë dhe Fjolla i shtrëngoi duart katër herë. Sa herë i shtrëngoi duart Erindi?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 0

15. Jetnori po luante basketboll. Pas 20 gjuajtjesh, ai kishte shënuar 55% të herëve. Pas pesë gjuajtjeve të tjera, raporti i shënimit u rrit në 56%. Në sa prej këtyre pesë gjuajtjeve shënoi Jetnori?


- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

16. Kaltrina palosi një fletë letre katrore saktësisht përgjysmë dy herë dhe pastaj e preu atë në mes dy herë, siç tregohet në figurë. Sa nga copat që ajo mori ishin katrorë?




- (A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 8

17. Mentori mban si kafshë shtëpiake qen, lopë, mace dhe kangur. Ai i thotë Helenës që ka në gjithsej 24 kafshë dhe që $\frac{1}{8}$ e tyre janë qen, $\frac{3}{4}$ NUK janë lopë dhe $\frac{2}{3}$ NUK janë mace. Sa kangurë mban Mentori?



- (A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 7 (E) 8

18. Mbi dysheme janë vizatuar disa drejtkëndësha të njëjtë. Mbi to është vizatuar një trekëndësh me bazë 10 cm dhe lartësi 6 cm, siç tregohet në figurë dhe është ngjyrosur zona jashtë trekëndëshit dhe brenda drejtkëndësive. Sa është syprina e zonës së ngjyrosur?




- (A) 10 cm^2 . (B) 12 cm^2 . (C) 14 cm^2 . (D) 15 cm^2 . (E) 21 cm^2 .

19. Loriku ka dy qirinj cilindrikë me lartësi dhe diametra të ndryshëm. Qiriu i parë shkrihet plotësisht për 6 orë, ndërsa qiriu i dytë për 8 orë. Ai i ndezi të dy qirinjtë njëherësh dhe tre orë më pas të dy qirinjtë kishin lartësi të njëjtë. Cili është raporti i lartësive të tyre fillestare?

- (A) 4 : 3 (B) 8 : 5 (C) 5 : 4 (D) 3 : 5 (E) 7 : 3


20. Afrimi donte të krijonte një shteg kalimi me fije shkrepseje duke përdorur sa më pak fije. Ai vendos secilën prej fijeve në letër përgjatë njëres prej vijave me pika, siç tregohet në figurë. Shtegu i tij vazhdon sipas rregullit: Numrat që janë shkruar në disa prej kuadrateve tregojnë numrin e fijeve të shkrepseve rreth këtij kuadrati. Sa fije shkrepseje përdori ai në këtë shteg që të përfundojë aty ku u nis?



- (A) 12 (B) 14 (C) 16 (D) 18 (E) 20

Problema me 5 pikë

21. Numrat natyrorë nga 1 deri te n , janë vendosur njëri pas tjetrit njëllëj larg sipas një rrethi. Një diametër i këtij rrethi bashkon numrat 7 dhe 23, siç tregohet në figurë. Sa është vlera e n ?




- (A) 30 (B) 32 (C) 34 (D) 36 (E) 38

22. Luani harxhoi të gjitha paratë e tij duke blerë 50 kanaçe me pije freskuese që kushtonte 100 Lekë secila. Ai shiti secilën kanaçe me të njëjtin çmim, që ishte më i lartë nga ai i blerjes. Pasi shiti

40 kanaçe, ai kishte 1000 Lekë më shumë se para blerjes. Sa para do të ketë Luani pasi t'i shesë të gjitha kanaçet?

- (A) 7000 Lekë (B) 7500 Lekë (C) 8000 Lekë (D) 9000 Lekë (E) 10000 Lekë


23. Natasha ka disa shkopinj me gjatësi 1 dm. Shkopinj të janë të ngjyrosur me një nga ngjyrat blu, e kuqe, e verdhë ose jeshile. Ajo dëshiron të ndërtojë një sgarë 3×3 , siç tregohet në figurë, në mënyrë që çdo katror 1×1 në sgarë të ketë brinjët me ngjyra të ndryshme. Sa është numri më i vogël



i shkopinjeve jeshil që mund të përdoren?

- (A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 7


24. Një milingonë dëshiron të ecë nëpër vijën e mbyllur, të shënuar në sipërfaqen e një kubi deri sa të kthehet në pozicionin e fillimit. Në cilin prej kubeve, që mund të formohen nga figurat e mëposhtme, është e mundur një lëvizje e tillë?



25. Elisabeta kishte një çantë të madhe me 60 çokollata. Ditën e hënë ajo hëngri një të 10-tën e tyre, ditën e martë hëngri një të 9-tën e atyre që kishin mbetur, ditën e mërkurë hëngri një të 8-tën e atyre që kishin mbetur, ditën e enjte hëngri një të 7-tën e kështu me radhë derisa hëngri gjysmën e çokollatave që kishin mbetur nga dita e mëparshme. Sa çokollata i mbetën asaj?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 6

26. Përparimi ngjyrosi secilin nga tetë rrathët e diagramës së mëposhtme me njërin nga ngjyrat e kuqe, e verdhë ose jeshile në mënyrë që çdo dy rrathë të lidhur të mos kenë të mos kenë ngjyrë të njëjtë. Cila dyshe rrathësh është ngjyrosur detyrimisht me të njëjtën ngjyrë?



- (A) 5 dhe 8 (B) 1 dhe 6 (C) 2 dhe 7 (D) 4 dhe 5 (E) 3 dhe 6

27. Kur Rudina dhe Flora krahasuan kursimet e tyre, gjetën që raporti i kursimeve ishte $5 : 3$. Kur Rudina bleu një tablet që kushtonte 16000 Lekë raporti i kursimeve të tyre ndryshoi në $3 : 5$. Sa Lekë kishte Rudina përpara se të blinte tabletin?


- (A) 192 (B) 200 (C) 250 (D) 400 (E) 420

28. Në një kampionat shahu morën pjesë disa skuadra me nga tre lojtarë. Çdo lojtar i një skuadër luan vetëm një herë kundër secilit lojtar nga të gjitha skuadrat e tjera. Për arsye të organizimit, nuk

mund të zhvillohen më shumë se 250 ndeshje gjithsej. Sa është numri më i madh i skuadrave që mund të marrin pjesë në këtë kampionat?

- (A) 11 (B) 10 (C) 9 (D) 8 (E) 7

29. Në figurën e mëposhtme jepet katrori $ABCD$ dhe pikat P , Q dhe R që janë meset përkatëse të brinjëve DA , BC dhe CD . Çfarë pjesë e katrorit $ABCD$ është vijëzuar?



- (A) $\frac{3}{4}$ (B) $\frac{5}{8}$ (C) $\frac{1}{2}$ (D) $\frac{7}{16}$ (E) $\frac{3}{8}$

30. Një tren përbëhet nga 18 vagonë. Në tren po udhëtojnë 700 udhëtarë. Në çdo grup prej pesë vagonash të njëpasnjëshëm ndodhen në tërësi 199 udhëtarë. Sa udhëtarë ndodhen në dy vagonat e mesit të trenit?

- (A) 70 (B) 77 (C) 78 (D) 96 (E) 103